

**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**  
**14 Nr. 520/21**  
**Dt. 23.08.2021**

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. NN “**Injering MSH “ me seli në Prizren**, kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik për Dhënie të Kontratës të publikuar më dt. **23.08.2021**, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 8 pika 8.1.2 paragrafi i të Rregullave për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, më datën **23.08.2021** bie këtë:

**V E N D I M**

- 1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar** Kërkesa për rishqyrtim, e subjektit në procedurë : NN“ **Injering MSH “ me seli në Prizren**, e datës **19.08.2021**, për rishikimin - rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit kundër vendimit për Dhënie të Kontratës të datës **18.08.2021** lidhur me aktivitetin e prokurimit : “ **Ndërtimi dhe rregullimi i rrethojave në shkolla, QKMF-re, QMF dhe AMF “** me nr. të prokurimit : Nr. Prok: **VU644 – 20 – 3738 – 5-2-1 / Nr. i Brendshëm: 644 – 20 – 059 – 521**
- 2.** Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së dhe nenin 8 pika 8.1.2 paragrafi ( i ) të Rregullave për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues do të vazhdoi me ri vlerësim të aktivitetit të prokurimit.
- 3.** Vendimi hynë në fuqi ditën e marrjes.

**A r s y e t i m**

Me vendimin e sajë, Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ka marrë vendim që , në aktivitetin e prokurimit : “ **Ndërtimi dhe rregullimi i rrethojave në shkolla, QKMF-re, QMF dhe AMF “** me nr. të prokurimit : Nr. Prok: **VU644 – 20 – 3738 – 5-2-1 / Nr. i Brendshëm: 644 – 20 – 059 – 521**, të shpërblej me kontratë Operatorin Ekonomik : **Lot. 2 “ Kopshti “sh.p.k. me seli në Vushtrri.**

Në Kërkesën për rishqyrtim parashtruar nga Op. Ek. NN “ **Injering MSH “ me seli në Prizren ( në tekstin e mëtejme Ankuesi )** e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor, parashtruesi i Kërkesës konsideron se me këtë rast janë shkelur dispozitat e LPP-së, neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo diskriminimi, neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Pasi u shqyrtuan pretendimet e Ankuesit të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim dhe vlerësimin të provave në shkresat e lëndës, u konstatua se Kërkesa për Rishqyrtim e Ankuesit është pjesërisht e bazuar. Në dosjen e tenderit, të dorëzuar përmes Platformës elektronike, është konstatuar padiskutueshëm se Ankuesi kishte dorëzuar ndaras tenderin e tij dhe Formularin e Tenderit në dy pjesë – Lote , për dallim nga O.E. tjerë pjesëmarrës të cilët tenderin e tyre duke përfshirë dhe Formularin e Tenderin e kanë dorëzuar në një pjesë. Fakti se Ankuesi nuk i ka identifikuar qarte dokumentet e dorëzuara në folderet e ndara, tek komisioni i vlerësimit kishte krijuar lajthitje, duke menduar dhe vlerësuar se Ankuesi ka tenderuar vetëm në Lotin 1. Mirëpo, pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit edhe njëherë të të dy fajleve të dorëzuara, u korrigjua

vlerësimi duke u konstatuar padiskutueshëm se Ankuesi kishte tenderuar në të dy Lotet, duke dorëzuar të rregullt dhe Formularin e tenderit, si për Lot. 1 ashtu dhe për Lot. 2. Të gjeturat tjera rreth rivlerësimit të tenderit të Ankuesit do të konkretizohen dhe materializohen gjatë procesit të ri-vlerësimit në Raportin e ri-vlerësimit.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 8 pika 8.1.2 paragrafi i të Rregullave për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa A.K. në procedurën e Ri-vlerësimit do të marrë Vendim meritot lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë

#### **Këshillë juridike:**


**Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtroi Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.**

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrisë  
K.R.. nr. 059/2021, datë 23.08.2021

Aktvendimi i dërgohet:

1. Palës/ ve
2. DKP
3. Arkiviti (1 kopje)

**Drejtoria për Prokurim Publik**

  
\_\_\_\_\_  
**Amir Haradinaj, ZPP**